



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**



**VENDIM**

Nr. 108, datë 30.03.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 13, DATË 04.02.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN E TYRE NË NJË PROGRAM TJETËR**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 13, datë 04.02.2021 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e

grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese të grantit të rindërtimit të banesave individuale, për shkak të pamundësisë për të rindërtuar në të njëjtin truall të subjekteve përfitues:

- Z. Naim Gjyzeli listuar në Aneksin 1 me numër rendor 35.
- Znj. Lumturi Farruku listuar në Aneksin 1 me numër rendor 15.

2. Miratimin e subjekteve përfitues, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, Manëz, sipas tabelës së mëposhtëme:

NR	NJËSIA ADM.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	ZONA E RE
1	MANËZ	NAIM	HAMDI	GJYZELI	5	3+1	MANËZ
2	MANËZ	LUMTURI	ELEZ	FARRUKU	3	2+1	MANËZ

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 05.04.2023**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 240/prot.  
13

Durrës, më 12.04.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**  
**DURRËS**  
**KRYETARIT TË BASHKISË**  
**DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.108 datë 30.03.2023 “për miratimin e ndryshimit të vendimit të këshillit bashkiak nr. 13, datë 04.02.2021, përsa i përket ndryshimit të listës emërore të familjeve përfituese të masës së grantit të rindërtimit të banesave individuale si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, për shkak të pamundësisë për të rindërtuar në të njëjtin truall dhe kalimin e tyre në një program tjetër”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij. Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

